

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e caktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *arsimi figurativ për klasën VI (e gjashtë)* në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore **arsimi figurativ** për klasën VI (gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçar 2020/21 bazohet në qëllimet /rezultatet e parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet rregullisht në bazë të planit mësimor të caktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, megjithatë duhet të ruhet fondi javor i orëve të parapara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndë mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë mësimore në programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin mësimor të rregullt.

2. PASQYRA E TEMAVE DHE NJËSITË MËSIMORE

Tema: **Vizatimi** (6 orë)

- Hyrje në artin figurative – pasqyra e temave për këtë vit shkollor dhe materialet e nevojshme. Vizatimi/hyrje në temën elementet figurative dhe parimet në vizatim;
- Elementet figurative dhe parimet në vizatim/llojet e vijave (kontura, vijë teksturë, dendësia e vijës, kompozicioni i vijave, ritmi i vijës);
- Mjetet e vizatimit dhe përdorimi i tyre/llojet e materialeve qymyr, tush, laps, një ngjyrë;
- Vlerësimi estetik i veprës artistike e përpunuar nga nxënësit ose nga autor i njohur maqedonas ose i huaj.

Tema: **Pikturimi** (6 orë)

- Pikturimi/hyrje në temë, elementet figurative dhe parimet ngjyra, kontrasti;

- Teknikat dhe materialet në pikturim përdorimi i tyre / kolazh, akuarel, shkallëzimi i tonit;
- Përdorimi i mjetet TIK/një përfaqësues nga pikturimi / ese;
- Vlerësimi estetik i veprës artistike e përpunuar nga nxënësit.

Tema: **Skulptura** (6 orë)

- Modelim / hyrja / lloji i formësimit, përfaqësuesit / mjetet TIK / kërkimi i përfaqësuesve maqedonas dhe të huaj (Power Point)
- Elementet figurative dhe parimet në modelim / proporcioni, simetria dhe asimetria, njohja me nocionin arkitektura / argjili
- Mjetet e modelimit / zbatimi i vijës dhe tekstura si dhe kompozicioni gjatë modelimit me argjilë dhe kombinimi i teknikave me materiale jo standard, plastikë, tel.../ materialet jo standarde
- Vlerësimi estetik i veprës artistike e përpunuar nga nxënësit

Tema: **Grafika** (7 orë)

- Elementet figurative në grafikë / njohja me skicën në grafikë, vija, tekstura, definimi i formave grafike
- Materialet figurative dhe teknikat në grafikë/njohja me teknikën vulë në karton
- Grafika kompjuterike mjetet e TIK
- Vlerësimi estetik i veprës artistike e përpunuar nga nxënësit

Tema: **Dizajni dhe komunikimi vizual** (7 orë)

- Llojet e dizajnit dhe rëndësia e tij /elementet figurative dhe parimet në dizajn, dallon figurën. elementet në objektet nga përdorimi i përditshëm;

- Elementet figurative dhe parimet – forma e sterilizuar dhe përfshin tekst në shprehjet figurative, ritmin në dizajn – teknika e kombinuar / filigran dhe elementet e stilizuara me origjinë natyrore si zbukurim për dorë me përfshirjen e emrit të pronarit;
- Komunikimi vizual / njihet me nocionin logo / –dizajni i omit – mjetet TIK;
- Vlerësimi estetik i veprës figurative e përpunuar nga nxënësit.

3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Programi mësimor i shkurtuar në lëndën mësimore *arsimi figurativ* për klasën VI (e gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21, do të realizohet në 32 orë mësimore. Përmbajtjet mësimore nga programi mbeten të njëjta, por të radhitura në kuadër të 32 orëve mësimore. Është bërë përmbledhja e përmbajtjeve mësimore nga temat e njëjta duke mbajtur llogari për ndërlidhjen logjike ndërmjet tyre. Rekomandohet që mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore ku integron dy ose më tepër përmbajtje mësimore, të jetë i kujdesshëm në aktivitetet dhe në kërkesat e dhëna. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njëjësive mësimore nga programi mësimor udhëhiqet nga rezultatet/qëllimet e pritura, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

Përcjelljen e arritjeve të nxënësve mësimdhënësi individualisht e integron në kuadër të orëve të parapara për realizim, duke përdorur metodat e ndryshme, teknikat dhe instrumentet. Informatat retroaktive në kohë dhe konstruktive ju mundëson nxënësve t'i identifikojnë hapat vijuese të nevojshme që të përparojnë në mësimnxënien e tyre.

Rekomandimet për fondin vjetor të orëve janë dhënë të orientuara së bashku me qëllimet konkrete dhe temat/përmbajtjet. Mësimdhënësi nuk kufizohet në radhitjen e temave dhe përmbajtjeve të nevojshme gjatë realizimit, por sipas kreativitetit personal dhe sipas arritjeve të nxënësve.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin e kuadrit mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin mësimor të shkurtuar në lëndën mësimore Arsimit figurativ për klasën VI (gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçarë për vitin shkollor 2020/21 e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska